



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJET E BASHKUARA**

**Nr. 7 Regjistri Themeltar
Nr. 3 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Xhezair ZAGANJORI	Kryesues
Ardian DVORANI	Anëtar
Arjana FULLANI	Anëtare
Evelina QIRJAKO	Anëtare
Andi ÇELIKU	Anëtar
Medi BICI	Anëtar
Guxim ZENELAJ	Anëtar
Edmond ISLAMAJ	Anëtar
Shkëlzen SELIMI	Anëtar
Artan ZENELI	Anëtar
Artan BROCI	Anëtar
Admir THANZA	Anëtar
Tom NDRECA	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 24.11.2016, mori në shqyrtim çështjen administrative nr.00005/2015, që u përket palëve:

PADITËS: **Përparim Zano**

I PADITUR: **Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës
Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë**

OBJEKTI: *Anulimin e vendimeve për caktimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.*

Të anulohet vendimi i rillogaritjes së të ardhurave nga pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve” i ndryshuar me aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010.

Detyrimin e palës së paditur të rillogarisë dhe të paguajë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Rillogaritja të bëhet sipas Ligjit nr.9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut” dhe Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996 i ndryshuar, të cilët parashikojnë si shumë të pensionit

masën prej 50% të pagës referuese, duke i shtuar 2% të kësaj page për çdo vit tjetër shërbimi mbi vjetërsinë prej 15 vjetësh.

Pagesa e pensionit të rillogaritjes si më sipër të fillojë nga data kur është caktuar pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie.

Detyrimin e palës së paditur të paguajë diferencat e papaguara ndërmjet pensionit të parakohshëm të rillogaritur sipas Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996, i ndryshuar dhe pensionit të përfunduar deri tani, që nga moment i lindjes së të drejtës për pension në vazhdim, deri në momentin e ekzekutimit të kësaj shume.

BAZA LIGJORE:

Nenet 31, 32/a, 153, 154, 324, 325 dhe 327 të Kodit të Procedurës Civile. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 4, 44, 132, 142/3; Ligji nr.8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr.9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut”. Ligji nr.9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve”, i ndryshuar; Ligji nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve”. Vendimi nr.9, datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.63, datë 01.02.2006.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me Vendimin nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

Detyrimin e palës së paditur të anuloj vendimin nr.25, datë 30.04.2007 lidhur me masën e pensionit, duke e rillogaritur atë në bazë të Ligjit nr.9418, datë 20.05.2005, i ndryshuar. Për 26 vite shërbimi, pagë referuese 46.860 Lekë, për 15 vite + 50%, pra $50 + (25-25) \times 2\% = 22\%$. Pagë referuese $46.860 \times 22\% = 33.739$ Lekë. Duke u aplikuar masa jo më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, si dhe indeksimet sipas VKM.

Detyrimin e palës së paditur t'i kthejë diferencën e krijuar për periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009 me masën 583.838 Lekë. Diferencë kjo e krijuar nga pensioni i dhënë nga pala e paditur me pensionin që i takon sipas ligjit.

Pushimin e gjykimit për kërkimet e tjera që i përkasin periudhës nga data 01.07.2009 e në vazhdim.

Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin nr.10-2014-879 (559), datë 14.02.2014 ka vendosur:

Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr.1784, datë 14.05.2014 ka vendosur:

Lënien në fuqi të Vendimit nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kundër Vendimit nr.1784, datë 14.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, e cila kërkon prishjen e Vendimit nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Durrës dhe Vendimit nr.1784, datë 14.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- *Gjykatat kanë gabuar në zgjidhjen e çështjes;*
- *Në llogaritjen e pensionit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës është mbështetur në nenin 11 të Ligjit nr.8087, datë 11.03.1996, të ndryshuar me Ligjin nr.8521, datë 30.07.1999;*
- *Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës ka vendosur rishqyrtimin e pensionit sipas kritereve të nenit 29 të Ligjit nr.10142, date 15.05.2009 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve”.*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore në praninë e palëve, më datë 02.02.2016, konstatoi se nga gjykatat e faktit, si dhe nga vetë ky Kolegj, vihet re se mbahen qëndrime të ndryshme në lidhje me problematikat e zbatimit në kohë dhe efektit prapaveprues të legjislacionit në lidhje me pensionin e parakohshëm të ushtarakëve për vjetërsi shërbimi, si dhe me mënyrën dhe skemën e zbatueshme për përllogaritjen e këtij pensioni sipas formulave të ndryshme që kanë parashikuar ligjet në kohë.

Konkretisht pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi parashikuar në Ligjin nr.8087, datë 11.03.1996 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar me Ligjin nr.8521, datë 30.07.1999 është llogaritur nga organet administrative të sigurimeve shoqërore sipas skemës së parashikuar nga neni 11. Kjo dispozitë parashikon se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi llogaritej sipas skemës: a) 50 për qind të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi; b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

Në praktikën gjyqësore janë vënë re dy qëndrime sa i takon zbatimit të kufizimit “*jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi*” në llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të parashikuar në Ligjin nr.8087/1996 të ndryshuar. Njëri qëndrim e zbaton kufizimin për të gjithë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, ashtu sikur zbatohet ky kufizim ligjor edhe nga organet administrative të sigurimeve shoqërore. Qëndrimi tjetër e zbaton kufizimin ligjor vetëm për pjesën që i shtohet pensionit të parakohshëm për vjetërsinë e shërbimit të parashikuar nga shkronja “b” e nenit 11 të ligjit të mësipërm.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9210, datë 23.03.2004 “*Për statusin e ushtarakëve*” kufizimi i mësipërm i parashikuar në nenin 11 të Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar, u shfuqizua nga neni 49 i këtij ligji. Miratimi i Ligjit nr.9210/2004 u pasua me daljen e Ligjit nr.9418, datë 20.05.2005 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve*”, të ndryshuar me Ligjin nr.9481, datë 16.02.2006.

Këto dy ligje parashikuan një skemë e re për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Konkretisht sipas nenit 14 të Ligjit nr.9418/2005 u parashikuar se: “1. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është 50 për qind e pagës referuese. 2. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese. 3. Masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, sipas përcaktimit të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”.

Ndërsa me nenin 2 të Ligjit nr.9481/2006 ky rregullim i mësipërm u ndryshua, duke u parashikuar se: “1. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është 50 për qind e pagës referuese.

2. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese. 3. Masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se: a) gjashtëfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për ushtarakët që mbajnë gradën gjeneral; b) pesëfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për ushtarakët që mbajnë gradën kolonel; c) katërfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për ushtarakët që mbajnë gradat major dhe nënkolonel; ç) trefishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për të gjithë ushtarakët e tjerë.”.

Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit të mësipërm, pra Ligjit nr.9210/2004, Ligjit nr.9418/2005 të ndryshuar me Ligjin nr.9481/2006. Kështu në praktikën gjyqësore me daljen e Ligjit nr.9214/2004 vihet re se është vendosur të hiqet kufizimi i pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për të gjithë përfituesit e tij, pra për ushtarakët që kanë përfituar pensionin e parakohshëm pas daljes së këtij ligji, si dhe në vijimësi pas daljes së Ligjit nr.9418/2005, të ndryshuar. Në këto raste gjykatat praktikisht kanë zbatuar skemën e parashikuar nga Ligji nr.8087/1996, i ndryshuar, duke hequr kufizimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të sipërcituar sipas Ligjit nr.9210/2004. Ky qëndrim i gjykatave ka ardhur pasi ato kanë vlerësuar të mos zbatojnë Ligjin nr.9418/2005, të ndryshuar, për shkak të mos daljes së akteve nënligjore në zbatim të tij. Ndërkohë ka gjykata që kanë bërë zgjidhje të tjera ligjore, të tilla që me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9418/2005, të ndryshuar, e kanë llogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas skemës së këtij ligji duke çmuar këtë ligj të vetëzbatueshëm, pa qenë e kushtëzuar zbatimin e tij nga mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore në bazë të nenit 32 të tij nga Këshilli i Ministrave.

Me miratimin e Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji nr.10142/2009), të ndryshuar me Aktin Normativ nr.5, datë 10.11.2010, skema e llogaritjes dhe masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndryshoi sërish. Në nenin 14 të këtij ligji parashikohet se: "1. Pensioni i parakohshëm, për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto, për çdo vit shërbimi. 2. Në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.". Ndërkohë Ligji nr.10142/2009 në nenin 29 të tij parashikon ndër të tjera rillogaritjen e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi të njohura tashmë me ligjet e tjera të mëparshme të sipërcituara.

Praktika gjyqësore në lidhje me zbatimin e këtij rregullimi ka ofruar të paktën dy qëndrime të ndryshme kur bëhet fjalë për të përcaktuar fuqinë prapavepruese të Ligjit nr.10142/2009, të ndryshuar, në pjesën që neni 29 urdhëron rillogaritjen e pensioneve të fituara dhe caktuara me ligjet e mëparshme. Ka qëndrime të gjykatave që në rillogaritjen e pensionit, sipas nenit 29 të Ligjit nr.10142/2009, a) përfshijnë periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit dhe b) që përfshijnë vetëm periudhën pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.10142/2009, të ndryshuar. Këto qëndrime kanë lindur për shkak të zbatimit të ndryshëm të Vendimit nr.33, datë 24.06.2010 dhe Vendimit nr.2, datë

18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në këto dy raste ka marrë ndër të tjera në shqyrtim edhe pretendimet në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike të Ligjit nr.10124/2009, të ndryshuar, për shkak të rillogaritjeve të pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, duke qenë se me zbatimin e skemës së këtij ligji dhe rillogaritjen e pensioneve mund të ulet masa e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi ka që janë njohur dhe llogaritur me ligjet e mëparshme.

Duke parë praktikatat e ndryshme ligjore të trajtuara më sipër në zbatim të legjislacionit që ka rregulluar në kohë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, rastet të paraqitura për shqyrtim në Gjykatë të Lartë, me qëllim shmangien e qëndrimeve të ndryshme mes gjykatave të faktit, por edhe të vetë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar se çështja duhet të dërgohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat morën në shqyrtim për të njehsuar qëndrimet në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. *Cilat janë efektet prapavepruese të zbatimit të Ligjit nr.10142/2009 të ndryshuar dhe shtuar me aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010 në lidhje me llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi?*
2. *Cili është ligji i zbatueshëm për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e Ushtarakut në Forcat e Armatosura të RSH” deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 të ndryshuar me aktin normativ nr.5, datë 10.11.2010?*
3. *Si duhet të përlllogaritet masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi parashikuar nga neni 11 i Ligji nr.8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA në RSH”, të ndryshuar me Ligjin nr.8521, datë 30.07.1999. Kufizimi “jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqësisë në shkallë vendi” duhet të zbatohet për të gjithë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi apo vetëm për shtesën në masën e këtij pensioni të parashikuar në shkronjën “b” të nenit 11 të këtij ligji?*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët z. Xhezair Zaganjori dhe znj. Arjana Fullani; përfaqësuesen e palës rekursive, Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që kërkuan ndryshimin e Vendimit nr.1784, datë 14.05.2014 të Gjykatës së Apelit dhe Vendimit nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e padisë; përfaqësuesin e Avokaturës së Shtetit, Avokatin e Shtetit z. Abaz Deda, që kërkoi po ashtu ndryshimin e Vendimit nr.1784, datë 14.05.2014 të Gjykatës së Apelit dhe Vendimit nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e padisë; si dhe konstatuan mungesën e paraqitjes së mbrojtësit të paditësit av. Arben Rakipi, si dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi është titulluar oficer aktiv me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr.1137, datë 01.06.1978. Ai ka shërbyer në Forcat e Armatosura deri më datën 29.07.2004, kur në kuadër të reformës në ushtri ka dalë në rezervë me Urdhrin nr.8487 të Ministrit të Mbrojtjes. Në momentin e daljes në rezervë

paditësi ka pasur gradën Kapiten i rangut të tretë (Major), me pagë referuese 46.860 Lekë, si dhe një periudhë shërbimi në ushtri prej 26 vjet e 3 muaj.

2. Pasi ka përfituar dy vjet pagën kalimtare, paditësi i ka kërkuar palës së paditur dhënien e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Me Vendimin nr.25, datë 30.04.2007 Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës ka vendosur trajtimin e paditësit me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, nga data 01.09.2006 deri më datë 20.03.2019, kur plotëson kushtet për pension pleqërie.

3. Pala e paditur e ka llogaritur pensionin bazuar në nenin 11 të Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA në RSH*”, të ndryshuar me Ligji nr.8521, datë 30.07.1999. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 pala e paditur, në bazë të nenit 29 të tij, ka rillogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas skemës të parashikuar në këtë ligj. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi pas rillogaritjes sipas skemës së re ligjore është më e ulët se ajo e njohur dhe dhënë më parë me vendimin objekt gjykimi.

4. Paditësi, duke mos qenë dakord me mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi. Paditësi pretendon se pala e paditur e ka llogaritur pensionin gabim, duke e kufizuar me masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, ndërkohë që ky kufizim është shfuqizuar me Ligjin nr.9210, datë 23.03.2004 “*Për statusin e ushtarakut në FA*”. Po ashtu paditësi kërkon që masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të mos i pakësohet me rillogaritjen sipas Ligjit nr.10142/2009, por ai të vazhdoj të trajtohet me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të llogaritur sipas skemës në momentin e lindjes së të drejtës për këtë pension.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me Vendimin nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 ka vendosur: *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur të anulloje Vendimin nr.25, datë 30.04.2007 lidhur me masën e pensionit, duke e rillogaritur atë në bazë të Ligjit nr.9418, datë 20.05.2005, të ndryshuar. Për 26 vite shërbimi, pagë referuese 46.860 Lekë, për 15 vite + 50%, pra $50 + (25-25) \times 2\% = 22\%$. Pagë referuese $46.860 \times 22\% = 33.739$ Lekë, duke u aplikuar masa jo më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, si dhe indeksimet sipas VKM. Detyrimin e palës së paditur t'i kthejë paditësit diferencën e krijuar për periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009 me masën 583.838 Lekë, diferencë kjo e krijuar nga pensioni i dhënë nga pala e paditur me pensionin që i takon sipas ligjit. Pushimin e gjykimit për kërkimet e tjera që i përkasin periudhës nga data 01.07.2009 e në vazhdim.*

6. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës paditësi është trajtuar me pension të parakohshëm si ish ushtarak që nga data 01.09.2006. Paga referuese që paditësi ka pasur në kohën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ka qenë 46.860 Lekë në muaj dhe masa e pensionit të përfituar nga paditësi ka qenë 16.356 Lekë në muaj. Kjo masë pensioni është llogaritur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, në bazë të Ligjit nr.8087, datë 11.03.1996, të ndryshuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës analizon se Ligji nr.9210, datë 23.3.2004 “*Për statusin e ushtarakut*” (i cili ka qenë në fuqi në kohën që paditësit i ka lindur e drejta për të përfituar pensionin e parakohshëm), në nenin 49 të tij ka shfuqizuar shprehjen “*jo më shumë se pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi*”, të gërmës “b” të Ligjit nr.8521 datë 30.7.1999, që ka ndryshuar Ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA në R.Sh*”. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, edhe nga interpretimi i dispozitës, del se legjislatori ka pasur parasysh që kufizimi “*jo më shumë se pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë*

vendit”, të ishte për pikën “b” të nenit 11. Ky kufizim u hoq fare me nenin 49 të Ligjit nr.9210, datë 30.3.2004. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës Ligji nr.8087/1996, i ndryshuar është shfuqizuar me Ligjin nr.9418, datë 20.05.2005, të ndryshuar me Ligjin nr.9481, datë 16.02.2006, sipas të cilit masa e pensionit kufizohet në rastin e paditësit sa katërfishi i pensionit bazë të pleqërisë. Kështu Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka konkluduar se zbatimi i nenit 11 të Ligjit nr.8687/1996 të ndryshuar nga pala e paditur është i pabazuar në ligj. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur të pranojë kërkimin e paditësit, siç është sipërcituar në pikën 5.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit nëpërmjet të cilit janë përcaktuar diferencat mes pensionit të dhënë dhe atij që i takonte paditësit deri me datën 01.07.2009, kur ka hyrë në fuqi Ligji nr.10142/2009 dhe kjo diferencë ka rezultuar në shumën 583.838 Lekë. Kështu, sipas kësaj gjykate, pala e paditur duhet t’i paguajë paditësi këtë shumë, pasi i ka përlllogaritur në mënyrë të pabazuar në ligj pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka analizuar se, sipas Ligjit nr.10142/2009, pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi do të rillogariten. Por, për kërkimin në lidhje me rillogaritjen e pensionit pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.10142/2009 paditësi hoqi dorë nga gjykimi. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pushuar gjykimi për këtë pjesë të padisë.

9. Kundër Vendimit nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, në Gjykatën e Apelit Durrës.

10. Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin nr.10-2014-879(559), datë 14.02.2014 ka shpallur moskompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes dhe ia ka dërguar atë Gjykatës Administrative të Apelit, në zbatim të Ligjit nr.49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*” dhe Vendimit Unifikues Administrativ nr.3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr.1784, datë 14.05.2014 ka lënë në fuqi Vendimin nr.2514 (11-2013-5458), datë 04.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi e ka vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj.

12. Gjykata e Administrative e Apelit ka arsyetuar se me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka argumentuar se pala e paditur ka lidhur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kundërshtim me ligjin. Konkretisht, sipas kësaj gjykate, pala e paditur ka zbatuar nenin 11 të Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996, të ndryshuar, duke kufizuar masën e këtij pensioni me pensionin maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, ndërkohë që ky kufizim ka qenë shfuqizuar nga neni 49 i Ligjit nr.9210/2014 “*Për statusin e ushtarakut*”. Gjykata Administrative e Apelit argumenton më tej se, sipas Ligjit nr.9418/2005, të ndryshuar, në fuqi në momentin e përfitimit të pensionit, ky i fundit duhej të caktohej në bazë të skemës të parashikuar në nenin 14 të tij dhe se, sipas Ligjit nr.9418/2005, kërkesat e Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996, të ndryshuar, nuk do të zbatohen për ushtarakët. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka kryer dhe ka administruar ekspertimin, sipas të cilit ka rezultuar se mes pensionit të llogaritur nga pala e paditur dhe atij që i takon paditësit ka diferencë në shumën 583,838 Lekë, për periudhën nga data 01.09.2006 deri më date 20.06.2009. Kështu sipas Gjykatës Administrative të Apelit, me të drejtë është vendosur nga gjykata e shkallës së parë që kjo shumë duhet t’i paguhet paditësit prej palës së paditur.

13. Kundër Vendimit nr.1784, datë 14.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, duke parashtruar shkaqet e sipërcituara në pjesën hyrëse të vendimit dhe pretenduar se skema e zbatueshme për llogaritjen e pensionit në momentin e lindjes së të drejtës është ajo e Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA në RSH”, të ndryshuar me Ligjin nr.8521, datë 30.07.1999, duke u kufizuar me masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi dhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.10142/2009 pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi duhet të rillogaritet sipas skemës së skemës së parashikuar në këtë ligj.

II. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

14. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në funksion të trajtimit njësuës të çështjeve të shtruara për diskutim, parashtrajnë dhe analizojnë fillimisht në mënyrë kronologjike parashikimet ligjore që rregullojnë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me Ligjin nr.8521, datë 30.07.1999 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, deri me daljen e Ligjit nr.10367, datë 23.12.2010 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.5, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009” “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

15. E drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të ushtarakëve i ka fillesat që me pensionin e parashikuar për ushtarakët në Ligjin nr.7496, datë 03.07.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Në nenin 16 të tij parashikohej se: “Oficerët dhe nënoficerët me vjetërsi shërbimi në ushtri 15 vjet për burrat dhe 12 për gratë, gëzojnë të drejtën e pensionit të pjesshëm në masën 50 për qind të pagës mujore. Për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore. Kriteret e dhënies së pensionit përcaktohen me ligjin “Për sigurimet shoqërore”.

16. Por ishte neni 11 i Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999, që parashikoi kushtet dhe kriteret për caktimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Sipas këtij rregullimi ligjor ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kanë dalë në rezervë dhe në lirim pas datës 03.07.1991, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, do të përfitonin pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi kur plotësonin vjetërsinë e shërbimit si ushtarak, në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kishin mbushur moshën 42 vjeç për gratë dhe 47 vjeç për burrat. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi parashikohej të llogaritej sipas skemës: a) 50% e pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

17. Më pas është miratuar Ligji nr.9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon ndër të tjera edhe të drejtën e ushtarakëve

për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Ky ligj në nenin 35 parashikon të njëjtën skemë për përllogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ligji i mëparshëm nr.8087/1996 i ndryshuar, me ndryshimin se nuk parashikonte më kufizimin ligjor të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Konkretisht kufizimin “*jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi*”, të parashikuar në germën “b” të nenit 11 të Ligjit të mëparshëm nr.8087/1996, të ndryshuar. Madje në nenin 49 të tij ligji parashikohej shfuqizimi i shprehjes “*por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi*” në shkronjën “b” të nenit 11 të Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996, të ndryshuar. Nga ana tjetër, neni 33 i Ligjit nr.9210/2004 parashikon rezervën ligjore, që kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përcaktohen në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në nenin 48 ky ligj parashikon se Këshilli i Ministrave, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin ndër të tjera edhe të nenit 35 të tij. Pra, sipas kësaj dispozite Këshilli i Ministrave kishte detyrimin të bënte rregullimet ligjore në lidhje me parashikimin e kriterëve dhe kushteve për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në ligjin “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura...”. *Sa më sipër Kolegjet e Bashkuara theksojnë se Ligji nr.9210/2004 hoqi kufizimin në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të parashikuar, por zbatimi i parashikimit ligjor të këtij ligji ishte i kushtëzuar me nxjerrjen e rregullimeve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve në zbatim të këtij ndryshimi.*

18. Më pas u miratua Ligji nr.9418, datë 20.05.2005 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”, i cili ndër të tjera në nenet 13 dhe 14 të tij parashikon kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Edhe sipas këtij ligji skema për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është e njëjtë me atë të parashikuar nga ligjet e mëparshme në fushën e sigurime shoqërore suplementare të ushtarakëve (Ligji nr.8087/1996, i ndryshuar) por me ndryshim sa i takon kufizimit të masës së këtij pensioni. Konkretisht sipas nenit 14 të ligjit, *masës së pensionit të parakohshëm i vihej kufizimi maksimal që ishte katërfishi i pensionit bazë, sipas përcaktimit të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*. Gjithashtu sipas këtij ligji parashikohet përllogaritja e pensionit për vjetërsi shërbimi për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura pavarësisht nga koha e daljes në lirim apo rezervë deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie, sipas Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”. Në lidhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr.8087/1996 të ndryshuar, Ligji nr.9418/2005 në nenin 33 të tij parashikon se nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitojnë prej tij.

19. Më pas me Ligjin nr.9481, datë 16.02.2006 u parashikuan ndryshime në Ligjin nr.9418, datë 20.05.2005 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”. Këto ndryshime kishin të bënin ndër të tjera me përcaktimin e subjekteve përfituese të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Konkretisht në nenin 1 të tij parashikohet se për ushtarakët e dalë në rezervë/lirim nga data 01.01.1991 deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9210, datë 23.03.2004 “*Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”, pavarësisht nga çasti i lindjes së të drejtës për përfitim pensioni të parakohshëm do të vazhdonin ta përfitonin këtë pension sipas Ligjit nr.8087, datë 13.03.1996, të ndryshuar. Po ashtu ky ligj parashikon të njëjtën skemë për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me atë të parashikuar nga ligji nr.9418/2005, por me ndryshimin përse i përket kufizimit të masës së tij, duke e lidhur me gradën e ushtarakut. Konkretisht në nenin 2 të ligjit

parashikohet se: masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se: a) gjashtëfishi i pensionit bazë në datën 1 janar të çdo vit për ushtarakët që mbajnë gradën gjeneral; b) pesëfishi i pensionit bazë në datën 1 janar të çdo viti për ushtarakët që mbajnë gradën kolonel; c) katërfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti për ushtarakët që mbajnë gradën major dhe nënkolonel; c) trefishi i pensionit bazë në datën 1 janar të çdo viti për të gjithë ushtarakët e tjerë.

20. Ligji nr.9481/2006 u bë objekt shqyrtimi prej Gjykatës Kushtetuese, e cila me Vendimi nr.9/2007 vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 1, 7 (shkronjat "a, b") dhe 9 të Ligjit nr.9481, datë 16.2.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

21. Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjen e saj analizoi parimin e sigurisë juridike, duke theksuar se është një nga elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe ka të bëjë me faktin se rregullimet ligjore për të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Gjykata Kushtetuese theksoi se shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive. Por, siç është theksuar dhe në Vendimin nr.34, të vitit 2005 të Gjykatës Kushtetuese, siguria juridike nuk mund të eliminojë çdo pasojë negative që mund t'i vijë individit nga rregullimi i ri, përderisa është e pandashme nga parimi i shtetit social. Prandaj edhe të drejtat e fituara mund të kufizohen si përjashtim, por kufizime të tilla mund të bëhen duke respektuar parimin e përpjesëtimit në lidhje të ngushtë me parimet e drejtësisë, e paanshmërisë dhe të mirëfunksionimit të shtetit. Kështu ndryshimet ligjore me ligjin nr.9841/2006 Gjykata Kushtetuese i konsideroi të tilla që ulin ndjeshëm masën e pensionit të një kategorie ushtarakësh dhe nuk rezulton të jenë bërë nga nevoja e domosdoshmërisë publike. Gjykata Kushtetuese argumentoi se siguria juridike mund të preket kur është fjala për të mbrojtur një interes publik, por në çështjen objekt gjykimi nuk u paraqitën dhe nuk u konstatuan shkaqe ose motive që justifikojnë domosdoshmërinë e prishjes së ekuilibrave të vendosura ose rrethanave të reja që të bënin të pamundur vlefshmërinë dhe efikasitetin e ligjit të mëparshëm për pensionet dhe të kërkonin marrjen e masave të tjera për të realizuar objektiva ligjorisht të synuara për t'u arritur.

22. Gjithashtu, në vendim Gjykata Kushtetuese u shpreh dhe në lidhje me efektin prapaveprues të Ligjit nr.9841/2006, duke pasur parasysh se ndryshimet ligjore ishin kundërshtuar para saj dhe për faktin se shtynin afatin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9418/2005. Gjykata Kushtetuese ndër të tjera u shpreh se, si rregull ligjet i shtrijnë efektet e tyre për kohën e ardhshme dhe fuqia prapavepruese e tyre zbatohet në raste përjashtimore sepse në të kundërt mundet të krijohen situata me pasoja të paparashikuara. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim si për shembull në ligjet penale favorizuese, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm e në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda negative ose të pandreqshme.

23. Gjykata Kushtetuese, në kushtet kur me shfuqizimin e dispozitave të sipërcituara të Ligjit nr.9481/2006 krijohej boshësi ligjore, bazuar në Ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i rekomandoi Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë të merrnin masa për të bërë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

24. Në këto kushte ligjvënësi miratoi Ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës

së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj në nenin 14 paragrafi i parë i tij parashikon të njëjtën skemë për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me atë të parashikuar nga ligjet e mëparshme në fushën e sigurime shoqërore suplementare të ushtarakëve (Ligji nr.8087/1996, i ndryshuar dhe Ligji nr.9418/2005 i ndryshuar) por me ndryshim sa i takon kufizimit të masës së këtij pensioni. Konkretisht në paragrafin e dytë të nenit 14, ligji vendos kufizim të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke parashikuar shprehimisht se: *masa e pensionit të parakohshëm, e llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, në çastin që lind e drejta për përfitim: a) për personat, që nuk kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; b) për personat, që kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtuar me 2 për qind të pagës mesatare referuese, për çdo vit sigurimi suplementar. Në këtë rast shuma e pensionit mujor të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë të pleqërisë, plus 20 për qind të pagës referuese të muajit të fundit të punës.*

25. Ligji nr.10142/2009 në nenin 29 të tij parashikon rillogaritjen e pensioneve të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur ky ishte njohur më parë. Konkretisht në pikën 1 të këtij neni parashikohet se: *dispozitat e ligjeve nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit" zbatohen deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në pikën 2 parashikohet se: Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare, të caktuara në përputhje me ligjet nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", si edhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha e vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës, do të rillogariten. Rillogaritja bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në bazë të pagave referuese, në çastin që i ka lindur e drejta për përfitim. Mbi këtë masë përfitimi të rivlerësuar zbatohen koeficientët e rritjes apo të indeksimit të pensionit, sipas vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, nga çasti i lindjes së të drejtës dhe deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Masa e pensionit, e rivlerësuar si më lart, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose e pensionit suplementar. Ndërsa në pikën 3 parashikohet se: Pensionet për vjetërsi shërbimi, kur plotësohen kriteret e nenit 11 të Ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe kur e drejta për përfitim ka lindur në harkun kohor 1.1.1999 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, por nuk është caktuar, llogariten sipas kriterëve të këtij ligji.*

26. Pra, në kuptim të nenit 29 të Ligjit nr.10142/2009 pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi të pacaktuara akoma, por për të cilat ka lindur e drejta në harkun kohor nga 01.01.1999 deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të llogariten sipas skemës së Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar, i cili, sipas pikës 1 të nenit 29, zbatohet deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142/2009. Gjithashtu sipas parashikimit ligjor të nenit 29, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142/2009 pensionet e caktuara më parë, qoftë edhe me vendim gjyqësor, do të rillogariten në bazë të rregullave të përcaktuara nga ky ligj.

27. Edhe ky ligj u bë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, e cila me Vendimin nr.33, datë 24.06.2010 shfuqizoi si antikushtetuese pikën 2 të nenit 14, si dhe nenin 27 të Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

28. Gjykata Kushtetuese u shpreh se ligji unifikon kushtet dhe masën e përfitimeve suplementare të disa kategorive përfituesish dhe se ky unifikim ka sjellë pasoja pozitive për një kategori përfituesish dhe pasoja negative për një tjetër kategori, prandaj disa prej dispozitave të ligjit cenojnë të drejtat e fituara për një pjesë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke ulur masën ose kohëzgjatjen e përfitimeve të tyre.

29. Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët, pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Ligjvënësi, duke marrë parasysh këtë konsideratë, parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohet ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe pensioni suplementar i pleqërisë janë të drejta, të cilat mbrohen nga parimi i sigurisë juridike.

30. Gjykata Kushtetuese analizon në lidhje me parimin e sigurisë juridike se ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijmësi me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Duke qenë se këto ligje e vendime perceptohen si burime pritshmërie të ligjshme për individët, ato nuk mund të ndryshohen e shfuqizohen në një fazë të mëvonshme. Ky parim u lejon individëve një lloj mbrojtjeje kundër ndryshimeve të menjëhershme e të pajustificueshme të rregullave. Por nga ana tjetër, sipas Gjykatës Kushtetuese, parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 02.11.2005).

31. Gjykata Kushtetuese argumenton se parashikimi i nenit 14/2 i ligjit 10142/2009 ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të shtetit të së drejtës pasi: a) me këtë rregullim të ri vendoset një kufizim në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke u vendosur një tavan maksimal; b) kufizimi sjell si pasojë uljen e masës së pensionit të parakohshëm për një kategori përfituesish; c) kjo ulje mund të jetë e përligjur në funksion të uljes së shpenzimeve buxhetore dhe vështirësive paguese të shtetit, por subjektet e interesuara parashtruan se shpenzimet e Buxhetit të Shtetit për këto përfitime nuk pësojnë ulje nga zbatimi i ligjit objekt gjykimi dhe këto subjekte nuk paraqiten përpara Gjykatës asnjë argument bindës që kjo ulje është bërë për arsye të një interesi publik. Në këto kushte Gjykata Kushtetuese argumenton se nisur nga funksioni dhe rëndësia e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, zvogëlimi i masës së tij ose kufizimi nga neni 14/2 e ligjit objekt gjykimi të shumëz maksimale që mund të përfitohet nuk janë veprime që mund të përligjen me interesin e rëndësishëm publik.

32. Në Vendimin nr.33, datë 24.06.2010, sa i takon nenit 29 të ligjit 10142/2009, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se *ky nen parashikon rillogaritjen e të drejtave të njohura në zbatim të ligjeve të mëparshme, pra parashikon se pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të pleqërisë të caktuara në përputhje me këto ligje, si dhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha dhe vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës do të rillogariten, pra këto dispozita mund të prekin, duke ulur/pakësuar ose duke rritur të drejtat e fituara.*

33. Gjykata Kushtetuese vlerësoi më tej se *qëllimi i dispozitave të nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, duke u nisur nga konteksti i saj, si dhe konteksti i përgjithshëm i këtij ligji, është që kjo rillogaritje e këtyre të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Në asnjë rast nuk lejohet që të kryhet një rillogaritje që do të çonte në përkeqësimin e situatës pozitive ose në cenimin e të drejtave të fituara. Në rast të kundërt, pra nëse do të bëhej një interpretim dhe zbatim ndryshe i kësaj dispozite, atëherë do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike. Nga subjektet e interesuara nuk u dhanë argumente për të justifikuar cenimin e sigurisë juridike për një interes të rëndësishëm publik.*

34. Gjykata Kushtetuese, bazuar në interpretim pajtues, arriti në përfundimin se neni 29 i Ligjit 10142, datë 15.05.2009 është i pajtueshëm me Kushtetutën dhe nuk cenon parimin e sigurisë juridike me kusht që të interpretohen si më sipër.

35. Pas vendimmarrjes së mësipërme të Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi ndërmori tjetër nismë legislative dhe miratoi Ligjin nr.10367, datë 23.12.2010 "*Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.5, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009" "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë"*. Më pas është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.793, datë 24.9.2010 "*Për zbatimin e ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë"*", i cili është ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.252, datë 9.2.2011.

36. Legjislacioni i mësipërm solli ndryshime që kishin të bënin: a) *me masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke u bazuar në përlllogaritjen e tij, jo më në pagën referuese mujore, por në pagën referuese mujore neto; si dhe b) me skemën e përlllogaritjes së këtij pensioni.* Konkretisht me ndryshimet e parashikuara në Aktin Normativ nr.5/2010, pika 1 dhe 2 e nenit 14 e ligjit nr.10142/2009 parashikon se: "*1. Pensioni i parakohshëm për personat që plotësojnë kushtet e përfitimi është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto për çdo vit shërbimi. 2. Në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"*.

37. Akti Normativ nr.5/2010 u bë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, e cila me Vendimin nr.2, datë 18.02.2013 u shpreh se ishte në përputhje me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se

referimi në ligj për llogaritjen e pensionit në vlerën neto të pagës ka çuar në ulje të masës së përfitimit të pensionit suplementar të ushtarakëve të liruar. Mbi analizën nëse kjo nismë ligjore cenonte parimin e sigurisë juridike, Gjykata Kushtetuese theksoi se ligjvënësi duhej të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht, mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive - konkretisht, trajtim më të mirë (financiar ose jo) - për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve ligjore e përkeqëson situatën pra, kur i heq subjekteve përfituese një të drejtë të fituar më parë. Megjithatë, parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor i ndryshëm i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyrshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike.

38. Kështu Gjykata Kushtetuese në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës në rastin konkret ka analizuar se ndërhyrja e ligjvënësit, pra kufizimi i të drejtës, ka qenë e nevojshme, pra e diktuar nga një interes publik, e arsyeshme dhe në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar ndërhyrjen, si dhe se nuk ka prekur thelbin e së drejtës. Në këtë kuptim Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se kufizimi është bërë me ligj dhe ndërhyrja në skemën e llogaritjes së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi është bërë për interes publik, për shkaqe të tilla si: a) efekti i papërballeshëm për buxhetin e shtetit; b) reduktimi i borxhit publik; c) presioni negativ i krizës globale financiare; ç) konsolidimi fiskal i qeverisë; d) funksionimi normal i skemës së sigurimeve shoqërore; dh) natyra e sigurimit shoqëror suplementar. Kështu Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar këto shkaqe të vlerësuara në dritën e interesit publik dhe nevojës për ndërhyrje të ligjvënësit dhe ekzekutivit në të drejta të fituara më parë, si të arsyeshme dhe proporcionale, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

39. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se natyra e sigurimit shoqëror suplementar është e ndryshme nga sigurimi shoqëror bazë, pasi qëllimi i të parit është shmangia e pasojave negative në ushtrimin e funksionit të një kategorie të caktuar të punonjësve, si dhe garantimi e ruajtja e të ardhurave për sigurimin e nevojave jetike të tyre. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese konkludoi se, ndryshimi i skemës së përfitimeve suplementare mbetet në diskrecion të politikave dhe mundësive të ekzekutivit, kurse prekja e skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet kurrësi të pësojë ndryshime të tilla që të përkeqësojë ndjeshëm jetën e shtetasve që përfitojnë këtë sigurim. Për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese vlerësoi se rasti objekt gjykimi paraqiste nevojën e interesit publik, që e justifikon ndërhyrjen e ligjvënësit në skemën e sigurimeve suplementare dhe se aktet objekt shqyrtimi respektojnë raportin e drejtë midis interesit publik dhe garantimit të mirëfunksionimit të buxhetit publik, i cili do të pësonte një goditje të konsiderueshme nëse nuk bëhej ndërhyrja në skemën e pensioneve.

40. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se, megjithëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit, kjo ndërhyrje është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar atë. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se diferencimet që ekzistonin para kësaj ndërhyrjeje cenonin parimet dhe rregullat në fushën e pagave dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe shkaktonin një detyrim të papërballeshëm për buxhetin e shtetit duke e rrezikuar atë seriozisht dhe se masa e pensionit e përlllogaritur sipas formulës së re mbështetet në mundësitë reale buxhetore, dhe se ajo siguron respektimin e parimeve të funksionimit të skemave suplementare, si dhe ruajtjen e raporteve të arsyeshme midis pensionit suplementar të ushtarakëve, atij të pleqërisë dhe pagës neto nga puna.

41. Në praktikë në lidhje me përlllogaritjen e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi janë vënë re problematika shumëvjeçare, të shkaktuara si pasojë e legjislacionit jo të

qëndrueshëm dhe të ndryshueshëm vazhdimisht, i cili është gjykuar dhe shfuqizuar disa herë nga Gjykata Kushtetuese. Me zbatimin e Aktit Normativ nr.5/2010 dhe si pasojë e efekteve prapavepruese të rillogaritjes së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 29 të Ligjit nr.10142/2009, kanë rezultuar ish ushtarakë debitorë nga shtetit për pensionet e përfituara. Në këto kushte ligjvënësi miratoi Ligjin nr.46/2016, datë 28.04.2016 “Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve në zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Sipas këtij ligji falen: a) detyrimet e papaguara që rezultojnë nga rillogaritja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 29 të Ligjit 10142/2009, të krijuara nga dhjetori 2010 (koha e zbatimit të Ligjit nr.10142/2009, i ndryshuar me Aktin Normativ nr.5/2010) deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.46/2016; si dhe b) detyrimet që do të krijohen si pasojë e rillogaritjes së pensionit në bazë të Ligjit nr.10142/2009, të ndryshuar, për ushtarakët që nuk u është kryer rillogaritja deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.26/2016.

III. Vlerësimet njëesuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Latë

42. Referuar Vendimit nr.33/2010 dhe Vendimit nr.2/2013 të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksojnë se, në zbatimin e nenit 29 të Ligjit nr.10142/2009, duhet pasur parasysh se parimi i sigurisë juridike, mund të cenohet nga ky rregullim i ri ligjor - pra masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi mund të ulet - duke respektuar kriteret kushtetuese për këtë qëllim, të parashikuara nga neni 17/1 i Kushtetutës, konkretisht mbrojtja e interesit publik dhe proporcionaliteti i ndërhyrjes në raport me qëllimin e synuar për t’u arritur. Në këtë mënyrë vendoset një raport i drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legislative, si dhe ruajtjes së thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror suplementar. Kështu, ndërsa në gjykimin e çështjes së kushtetutshmërisë së Ligjit nr.10142/2009 Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se organet shtetërore ligjbërëse nuk dhanë argumente për të justifikuar cenimin e sigurisë juridike për një interes të rëndësishëm publik, ky vlerësim nënkuptonte se, nëse e kundërta do të ndodhte, pra nëse për interesa të rëndësishme publike cenohet parimi i sigurisë juridike përmes uljes së masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, atëherë nisma legislative mund të jetë në përputhje me parimet kushtetuese. Ky qëndrim, i mbajtur tashmë drejtpërdrejt, u konfirmua më pas, kur Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr.2/2013 mori në shqyrtim kushtetutshmërinë e Aktit Normativ nr.5/2010. Sikur u soll në vëmendje më lart, Gjykata Kushtetuese pranoi se masa e pensionit mund të ulet kur e diktonin interesat publike të ruajtjes së sistemit financiar ekonomik të shtetit në skemën e sigurimeve shoqërore. Duke qenë se situata ekonomike financiare në fushën e sigurimeve shoqërore të pensioneve të parakohshme paraqitej e tillë, atëherë Gjykata Kushtetuese e konsideroi në përputhje me Kushtetutën këtë ndërhyrje legislative që përkeqësonte situatën e përfituesve të këtij pensioni duke parashikuar një masë më të ulët të tij.

43. Sa më sipër Kolegjet e Bashkuara theksojnë se tashmë, sikur është pranuar nga Gjykata Kushtetuese, neni 29 i Ligjit 10142/2009 u miratua pikërisht për të mbështetur në mundësitë reale buxhetore skemën e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi. Në këtë kontekst, për efekt të njehsimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se: *rillogaritja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 29 i Ligjit nr.10142/2009, do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, edhe në situatën kur kjo*

rillogaritje ul masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të njohur dhe caktuar më parë.

44. Pasi konkluduan sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të analizojnë dhe marrin në shqyrtim çështjen e zbatimit me fuqi prapavepruese të nenit 29 të Ligjit nr.10142/2009. Sipas pikës së parë të këtij neni, ligji i zbatueshëm, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142/2009, për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është Ligji nr.8087, datë 13.03.1996 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”. Ndërkohë në pikën 3 të këtij neni parashikohet se kur e drejta për përfitim pensioni të parakohshëm ka lindur prej datës 01.01.1999, deri me hyrjen në fuqi të ligjit nr.1042/2009, por pensioni nuk është caktuar akoma, pensioni i parakohshëm do të llogaritet sipas nenit 11 të Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar. Pra, sipas këtyre rregullimeve ligjore të nenit 29, parashikohet skema e llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me fuqi prapavepruese dhe përcaktohet se, pavarësisht kur ka lindur e drejta për përfitim, në harkun kohor nga data 01.01.1999 deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142/2009, do zbatohet Ligji nr.8087/1996 i ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999.

45. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksojnë se, zbatimi i mësipërm i nenit 29 të Ligjit nr.10142/2009 bën që të mos zbatohet ligji për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura nr.9418/2005, i ndryshuar me Ligjin nr.9481/2006, për përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbim në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi. Ky parashikim ligjor cenon parimin e sigurisë juridike, por Kolegjet e Bashkuara ritheksojnë se zbatimi i ligjit përmbush kriteret kushtetuese për cënimin e sigurisë juridike kur diktohet nga interesi publik, mbrojtja e të cilit do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike, sikur është elaboruar më lart në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

46. Kështu në rastin konkret parashikimi i nenit 29 të ligjit është ndërhyrje e shtetit në legjislacionin e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve, që erdhi si rezultat i situatës së rëndë ekonomike financiare në skemën e sigurimeve shoqërore të këtyre pensioneve, sikur vlerësohet në Vendimin nr.2/2013 të Gjykatës Kushtetuese. Sa më sipër, një zbatim i tillë me fuqi prapavepruese i nenit 29 të ligjit është në përputhje me Kushtetutën, sikurse është vlerësuar edhe me Vendimin nr.33/2010 dhe Vendimin nr.2/2013 të Gjykatës Kushtetuese. Kjo mënyrë zbatimi e ligjit në kohë përmbush edhe kriteret e kushtetutshmërisë, edhe nëse çon në përfitimin e një mase më të ulët të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, për shkak të llogaritjes sipas skemës së nenit 11 të Ligjit nr.8087/1996 të ndryshuar, dhe jo sipas skemës së parashikuar nga Ligji nr.9418/2005, i ndryshuar, i cili mund të jetë ligji në fuqi në momentin e lindjes së të drejtës.

47. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të njehsimit të praktikës gjyqësore, arrijnë në përfundimin se: ***në gjykimin e mosmarrëveshjeve për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, për periudhën nga data 01.01.1999 deri më hyrjen në fuqi të ligjit nr.10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritet sipas Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999. Në rastet kur e drejta për pension ka lindur pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9418/2005 të ndryshuar me Ligjin nr.9481/2006, deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142/2009 të ndryshuar, në kuptim të nenit 29 të këtij ligji, skema për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, e parashikuar nga Ligji nr.9418/2005 të ndryshuar me Ligjin nr.9481/2006, nuk zbatohet, pavarësisht nëse masa e pensionit rritet apo ulet në raport me skemën e parashikuar nga Ligji nr.8087/1996, të ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999.***

48. Në lidhje me çështjen e shtruar për njehsim, për mënyrën e përlllogaritjes së masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në bazë të nenit 11 të Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksojnë se, sipas këtij neni përfitojnë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi ushtarakët aktivë kur plotësojnë vjetërsinë e shërbimit si ushtarak në moshën: *12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kenë mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç*. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi llogaritet sipas skemës: *a) 50% e pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi*.

49. Sipas këtij rregullimi ligjor pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi është 50% e pagës referuese, mbi të cilën është derdhur kontributi, dhe për çdo vit, tej periudhës 12 vjet vjetërsi shërbimi për gratë dhe 15 vjet vjetërsi shërbimi për burrat, shumës së mësipërme i shtohet 2% të pagës referuese. Çështja që shtohet për zgjidhje është nëse kufizimi “*jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqësisë në shkallë vendi*” duhet të zbatohet për të gjithë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, apo për shtesën për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit.

50. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vënë në dukje se, në të gjitha ligjet në fushën e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve, kufizimi në shumën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është parashikuar mbi të gjithë shumën e tij, përveç ndryshimeve të fundit të bëra me aktin normativ nr.5/2010, ku është vendosur si kriter dysheme për llogaritjen e tij pensioni bazë i pleqërisë, pra masa më e ulët e pensionit të pleqërisë. Në kuptim të mënyrës së rregullimit ligjor të këtij pensioni nga legjislatori, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë theksojnë se tavani i vendosur në lidhje me masën e pensionit të parakohshëm në nenin 11 të Ligjit nr.8087/1996, të ndryshuar, duhet të zbatohet mbi të gjithë masën e pensionit të parakohshëm. Pra, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas parashikimit të Ligjit nr.8087/1996, i ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999, nuk mund të jetë më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

51. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin njësoes se: ***caktimi i pensionit të parakohshëm, sipas nenit 11 të Ligjit nr.8087/1996, i ndryshuar me Ligjin nr.8521/1999, bëhet duke u llogaritur sipas skemës: a) 50% e pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi; dhe b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese. Por masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.***

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

52. Përsa i përket rastit në gjykim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se të dy gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material, pasi i kanë njohur dhe i kanë përlllogaritur paditësit pensionin sipas ligjit nr.9418/2005, i ndryshuar, ndonëse, sipas nenit 29 të Ligjit nr.10141/2009, pensionet e parakohshme të vjetërsisë në shërbim, për personat që i ka lindur e drejta për pension para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të llogariteshin sipas Ligjit nr.8087/1999, të ndryshuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri, më pas ky pension do të rillogaritet sipas parashikimeve të Ligjit nr.10141/2009 të ndryshuar.

52. Ndodhur në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se në rastin në gjykim gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe, nisur nga interpretimi i

mësipërm njësues, çështja duhet të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Administrative të Apelit, por me tjetër trup gjykues, e cila si një gjykatë fakti ka mundësinë ligjore të ndreqë zbatimin e gabuar të ligjit të bërë në gjykimin e mëparshëm. Në rigjykim, kjo gjykatë duhet të garantojë kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes dhe të analizojë faktet për të zgjidhur çështjen në kuadër të zbatimit të ligjit sipas orientimit njësues të këtij vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 141 të Kushtetutës, në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në nenet 17, pika “a” dhe 19§4 të Ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, nenet 32, 33, 35/4 të ligjit nr.98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.1784, datë 14.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.
Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 24.11.2016

ANËTARE
Arjana FULLANI

ANËTAR
Ardian DVORANI

KRYESUES
Xhezair ZAGANJORI

ANËTAR
Shkëlzen SELIMI

ANËTARE
Evelina QIRJAKO

ANËTAR
Tom NDRECA

ANËTAR
Medi BICI

ANËTAR
Artan ZENELI

ANËTAR
Guxim ZENELAJ

ANËTAR
Andi ÇELIKU

ANËTAR
Edmond ISLAMAJ

ANËTAR
Admir THANZA

ANËTAR
Artan BROCI